



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.03.2026
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkryetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – SHKURT 2026

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2026, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUdhËN RAPORTUESE 01.02.2026-28.02.2026

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit shkurt 2026-janë pranuar gjithsejtë 50¹-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 17 lëndë, në total 67 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 54 kërkesa, 37 të miratuara, 15 të refuzuara, 1 pushim procedure dhe 1 të bartura në kompetencë. Për shqyrtim në muajin vijues (mars 2026) barten 13 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 14 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 3 konkluzione për leje ndërtimi, 4 për leje mjedisore komunale, 3 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi, 3 për certifikatë legalizimi dhe 1 për shtrirje rrjetit energjetik.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj është lëshuar 1 ftesë për kompletim të lëndës. Brenda muajit shkurt janë pranuar dy kërkesa për plotësimin e lëndëve. Edhe gjatë këtij muaji kishte mjaft kërkesa të drejtpërdrejta (informative) lidhur me ndryshimin/plotësimin e HZK².

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Janë përgatitur dhe prezantuar materialet për Kuvendin e Komunës të mbajtur me 12.02.2026, duke përfshirë propozim ndryshimin dhe plotësimin e HZK, themelimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, etj.

Janë proceduar administrativisht të gjitha kërkesat për kryerjen e pagesave sipas detyrimeve të arritura.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM. Në këtë proces kanë qenë të angazhuar dy punonjës të përkohshëm të cilët e kanë përfunduar kontraten me 28 shkurt 2026.

Në takim pune me Agjencinë Kadastrale të Kosovës është trajtuar çështja e para regjistrimit të lejeve të ndërtimit në dokumentacionin kadastral, regjistrimi i ndërtesave të legalizuara dhe çështja e sistemit unik të adresave, përkatësisht ndërlihdja e qytetarëve me adresen.

Afati për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi është vazhduar edhe për vitin 2026. Ky proces është tepër sfidues. Megjithatë, brenda këtyre dy muajve të këtij viti kemi pranuar vetëm një kërkesë të re dhe një kërkesë të përsërtitur nga viti paraprak. Në bazë të kësaj vlerësojmë se interesimi i qytetarëve është tejet i ulët.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

- *Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të bartura;*

¹ Janë pranuar edhe 2 kërkesa të tjera për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraprakisht.

² Këto kërkesa duhet të trajtohen në procesin e ndryshim/plotësimit të HZK-së.

- Fillimi i zbatimit të vendimeve të miratuara në seancën e Kuvendit të mbajtur më 12.02.2026.
- Çështja e menaxhimit të regjistrimit të adresave pas përfundimit të projektit.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	6	4	5		4		1
2.	Leje ndërtimi	7	3	2		3		5
3.	Leje rrënimi							
4.	Certifikatë Përdorimi							
5.	Shtyrje afati LN							
6.	QRTK-bartje në kompetencë							
7.	Informacione urbane	9		8		1		
8.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	2	4	3	1			2
9.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
10.	Bashkim/ndarje e parcelave	2		1		1		
11.	Kërkesë për LMK	4	3	4		1		2
12.	Qasje në dokumente	1		1				
13.	KN për park solar	1				1		
14.	MMPHI-pëlq.mjed.	1		1				
15.	MMPHI – mirat. ankese	1						1
16.	Pëlqim për rrjet energj.	3	1	1		2		1
17.	Mbroj. Mjed. ligatina	1		1				
18.	Tërheqje lënde	1		1				
19.	Kërkesë për shpronësim		2	2 ³				
20.	Tokë për shtatore	1				1		
21.	Vazhdim i L.ndërtim.	1		1				
22.	Vazhdim afati LMK	1		1				
23.	Rrënim muri	1				1		
24.	Dokumente për Gjykatën në Graçanicë	1		1				
25.	Riemertim rruge	1					1	
26.	Shtyerje afati legalizim	1		1				
27.	Të dhena për performance	2		2				
28.	Pyetësori për PAK ⁴	1						1
29.	Raporti për menxh. e mbeturinave	1		1				
	Gjithsejtë:	50	17	37	1	15	1	13

³ Janë dhënë përgjigjet përkatëse

⁴ Në Raport duhet të prezantohen të dhënat lidhur me ndërtesat me leje që plotësojnë kërkesat teknike për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e ndërtimit</i>	<i>Sipërf. Tokës – m2</i>	<i>Sip.nderësës- m2</i>	<i>Destinimi</i>	<i>Vendi</i>
1.	II	21715	Bodrumi – 9229.10 Përdhesa – 9873.60 Banim – 24374.80	NLB	Lipjan (Grackë e Vjetër)
2.	II	5500	2130	Afarist	Banullë
Gjithsejtë		27215	45607.5		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 5500 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 2130 m2, kurse tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm në qytet 21715 m2 në të cilën janë dhënë për ndërtim 3215.8 m2 bodrum, 9873.60 m2 afarizëm dhe 24374.80 m2 për banim (NLB).

Buxheti:

Gjatë muajit shkurt 2026 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë realizuar në shumat si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....8,725.44⁵€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:5,500.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....28,361.05€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....1,935,99€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej00€

Shuma totale e të hyrave:44,522.48€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin shkurt 2026 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me shpenzimet kemi proceduar me pagesa për kryerjen e detyrimeve të maturuara për muajin shkurt 2026. Mjetet e planifikuara për shpenzim janë nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime”.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit shkurt 2026 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

⁵ Shuma prej 196,486.69€ e paguar me 27.02.26 për Leje ndërtimi, nuk është prezantuar në këtë Raport, meqenëse sipas Drejtoratit të financave kjo shumë regjistrohet në muajin mars, prandaj e njehta do të prezantohet në muajin vijues.